



ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 123, Datë 06.05.2026

MBI

**MIRATIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË “ERSEKA SOLAR PARK 1” SH.P.K. PËR  
KRIJIMIN E LLOGARISË NË REGJISTRIN ELEKTRONIK TË GARANCIVE TË  
ORIGJINËS DHE REGJISTRIMIN FILLESTAR TË PAJISJEVE TË PRODHIMIT PËR  
CENTRALIN FOTOVOLTAIK**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 22 të ligjit nr. 24/2023, “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”; nenit 6 të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 300, datë 30.12.2024; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 06.05.2026, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, me nr. 1040/3 prot., datë 05.05.2026 “Mbi shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për centralin fotovoltaik”,

**Konstatoi se:**

**1. Të dhëna mbi shoqërinë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k.**

- Shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. është licencuar në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, me vendimin e bordit të ERE-s nr. 176, datë 18.05.2023, për centralin fotovoltaik me kapacitet 20 MW, në Njësinë Administrative të Qendrës Ersekë, Bashkia Kolonjë, Qarku Korçë dhe në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike me vendimin e bordit të ERE-s nr. 231, datë 30.10.2024.

**2. Korrespondenca dhe Dokumentacioni i Depozituar nga Shoqëria**

- Shoqëria “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. me shkresën nr. 1040/2 prot, datë 23.04.2026, ka paraqitur kërkesën për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për centralin fotovoltaik, si dhe kërkesën për pajisjen me garanci të origjinës për prodhimin e gjeneruar nga impianti fotovoltaik “Erseka Solar Park 1” për periudhën Janar 2026 – Mars 2026.
- Shoqëria ka bashkëlidhur formularin e aplikimit të plotësuar, sipas kërkesave të nenit 6 të “Rregullores për lëshimin, transferimin, shlyerjen dhe anulimin e garancive të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme”, duke specifikuar të dhënat identifikuese dhe teknike të pajisjeve të prodhimit, përfshirë karakteristikat teknike të centralit fotovoltaik, të dhënat mbi kapacitetin e instaluar, pikën e matjes, etj.

- Sa më sipër cituar, kjo shoqëri fillimisht, me shkresën nr. 1040 prot., datë 01.04.2026 ka përcjellë në ERE “Kërkesë për pajisje me GO për prodhimin e gjeneruar nga impianti fotovoltaiik “Erseka Solar Park 1”, për periudhën Dhjetor 2024 – Dhjetor 2025”.
- ERE , në përgjigje të kërkesës, me shkresën nr. 1040/1/1 prot., datë 14.04.2026, i ka bërë me dije shoqërisë se në zbatim të nenit 6 të Rregullores në fuqi të miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 300, datë 30.12.2024, shoqëria duhet të paraqesë në fillim kërkesën për krijimin e një llogarie në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, së bashku me të dhënat e përcaktuara në pikën 4 të këtij neni dhe se referuar përcaktimeve të pikës 7, të nenit 12 të rregullores, garancia e origjinës është e vlefshme për një vit duke filluar nga dita e fundit e periudhës së prodhimit për të cilën është lëshuar.
- Pas miratimit/vendimarrjes së bordit të ERE-s, shoqëria do të njoftohet në mënyrë që të publikojë në portalin sasi të energjisë elektrike të prodhuara për muajt Janar – Mars 2026, për të cilat kërkon dhe lëshimin e GO.

### 3. Analiza Ligjore dhe Vlerësimi

- Në përputhje me nenin 22 të ligjit nr. 24/2023 “Për nxitjen e përdorimit të energjisë nga burimet e rinovueshme”, ERE është organi kombëtar lëshues i garancive të origjinës dhe mban një regjistër elektronik për qëllime të lëshimit dhe administrimit të këtyre certifikatave.
- Në bazë të dokumentacionit të paraqitur, konstatohet se centrali fotovoltaiik për të cilin kërkohet regjistrimi klasifikohet i përshtatshëm për lëshimin e garancive të origjinës sipas nenit 6 të Rregullores dhe tabelës 1.1 të saj.
- Vlerësohet se kërkesa përmbush të gjitha kriteret për regjistrimin fillestar dhe hapjen e llogarisë në regjistër si prodhues i energjisë elektrike nga burime të rinovueshme.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Miratimin e kërkesës së shoqërisë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. për krijimin e llogarisë në regjistrin elektronik të garancive të origjinës, në kategorinë prodhues dhe tregtar i energjisë elektrike dhe regjistrimin fillestar të pajisjeve të prodhimit për centralin fotovoltaiik.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë “Erseka Solar Park 1” sh.p.k. lidhur me vendimin e bordit të ERE.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**